

32-027.21(049.3)

Murat M. ALIU<sup>1</sup>

**NJË ANALIZË LIBRIT “MBI POLITIKËN” TË AUTORES  
CHANTAL MOUFFE**

**АНАЛИЗА НА КНИГАТА “ЗА ПОЛИТИКАТА” ОД АВТОРОТ  
ШАНТАЛ МУФЕ**

**AN ANALYSIS OF THE BOOK “ON THE POLITICAL” OF THE  
AUTHOR CHANTAL MOUFFE**

**Abstract**

In this paper in fact we will be doing an analyze of the book “On Politics” of the author Chantal Mouffe, one which with her ideas and scientific work has enriched the theoretic background of political and social sciences. The fundamental thesis of the book we will analyze is that the model of consensual and representative democracy, today is in a deep crisis and as a consequence of this; democratic institutions have failed the solving of many problems around the world. Mouffe claims that the promises of the liberalists for a more democratic and peaceful world failed and that instead of peace and democracy the world today faces problems of different natures and that antagonisms have become fundamental characteristics of this world. Mouffe suggests a model of democratic politics which will transform antagonisms into agonies. So, agonistic politics will present the main basis of her democratic model. Whereas, the model she suggests is the model of radical democracy.

**Keywords:** Liberalism, democracy, politics, political, antagonism, agonism.

Në kapitullin e parë që njëherit përbën edhe hyrjen e këtij libri, autorja Mouffe, ndryshe nga shumë autorë apo teoricienë, dy konceptet,

---

<sup>1</sup> Doktorant në Universitetin e Stambollit, Drejtimi Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.

atë të “demokracisë” dhe “politikës” mundohet t’i interpretojë nga një këndvështrim tjetër dhe në këtë kontekst ajo vendos në pah një botë-kuptim më ndryshe mbi këto koncepte. Mouffe duke mbështetur tezën se dimensionin antagonistik është pjesë përbërëse të *politikes*, refuzon idetë e shumë sociologëve dhe politikologëve të cilët pas luftës së ftohtë shtruan idetë për një botë absolutisht paqësore dhe një “botë pa armiq”. Thënë ndryshe, Mouffe kritikon teoritë e shumë autorëve liberalë për një botë post-politike. Sepse, sipas saj, edhe përkundër rënies së murit të Berlinit dhe shpalljes së fitores së demokracisë liberale nga ana e perëndimit, sot demokracia gjendet në një krizë të thellë institucionale. Sot konceptet “demokracia dialogjike”, “demokracia absolute”, “demokracia kozmopolite” reflektojnë një vizion anti-politik dhe në fakt refuzojnë dimensionin antagonistik dhe përplasës të *politikes*. Mouffe thotë që qëllimi i të gjitha këtyre qasjeve të reja është krijimi i një bote “përtej hegjemonisë”, “përtej së majtës dhe së djathtës” dhe “përtej antagonizmave”. Mirëpo Mouffe mendon se dëshira për një botë të tillë, në fakt mund të prodhojë efekte të kundërta, pra, modelet e demokracisë të lartpërmendura në vend të eliminimit të antagonizmave dhe përplasjeve shoqërore, në fakt mund të stimulojnë akoma më shumë antagonizma (Mouffe, 2013: 8).

Duke u bazuar në këtë, sipas Mouffe në asnjë mënyrë nuk është e mundur arritja e konsensusit universal. Sipas saj, në vend që të përpiqemi të projektojmë institucione të cilat do të bëjnë të mundur konsensusin e përplasjeve në baza të interesit, duhet hapur hapësira publike ku do t’u jepet mundësia projekteve të ndryshme politike të ballafaqohen në një formë agonistike. Pra Mouffe duke pranuar dimensionin antagonistik të *politikes* në fakt refuzon modelin konsensual demokracisë liberale. Sepse liberalizmi synon arritjen e një konsensusi universal ndërmjet të gjithë grupeve dhe identiteteve. Në fakt sipas Mouffe ideja e konsensusit universal është një utopi e cila nuk mund të arrihet asnjëherë. Në këtë kontekst nuk është i mundur as edhe eliminimi i dimensionit antagonistik të jetës shoqërore.

Sot një numër i madh i teoricienëve duke refuzuar konceptimin e Karl Schmitt-it mbi *politiken*, besojnë në gjendjen post-politike dhe politikën gjithmonë e interpretojnë nga një perspektivë moraliste. Si pasojë e kësaj sot politika në shumë raste konsumohet më një gjuhë moraliste. Konsumimi i politikës me një gjuhë moraliste ka shkaktuar segregacionin ndërmjet dy kampeve, ky njëra palë gjithmonë ka “të drejtë” kurse pala tjetër gjithmonë “është gabim”.

Në pjesën e dytë të librit autorja në fjalë analizon natyrën e nocionit apo konceptit të *politikes* dhe këtë nocion e analizon brenda kornizës dikotomike “antagonizëm” dhe “agonizëm”. Kur bëhet fjalë për politikën demokratike, sipas Mouffit çështja esenciale është se si antagonizmat të transformohen në dikotominë “Ne/Ju” i cili do të jetë i përshtatshëm për modelin pluralist. Pra politikëbërja brenda kornizës së ndarjes në “Ne dhe Ju” në fakt do të paraqesë modelin politikë agonistik (Mouffe, 2015: 29).

Mouffe për ta kuptuar më së miri tezën e saj mbi modelin e politikës demokratike agonistike propozon të analizojmë konceptimin e *politikes* të Karl Schmitt-it. Sipas Schmitt-it në fushën politike gjithmonë do të ekzistojnë antagonizmat, sepse antagonizmat janë ata që e mundësojnë politikën. Pra nëse nuk ekziston dimensionin antagonistik i *politikes*, atëherë është e pamundur të flasësh për marrëdhënie politike. Në këtë kontekst ndarja në mik/armik përbën elementin konstituiv të politikës. Pra sipas Schmitt-it “nëse ndarja mik/armik eliminohet, atëherë eliminohet edhe jeta politike” (Schmitt, 2014:81). Pra konceptimi i Schmitt-it mbi natyrën e *politikes* në esencë paraqet një antitezë të konceptimi të politikës nga ana e liberalistëve. Sepse mendimi liberal duke qenë i lidhur ngushtë me racionalizmin dhe individualizmin mohan dimensionin antagonistik të *politikes*, debatin politik e paraqet si një fushë origjinale ku do të aplikohet morali dhe beson që nëpërmjet debatit të lirë në fushën politike mund të arrihet një konsensus moral dhe racional (Mouffe, 2013:19).

Konceptimi i politikës nga ana e Mouffi-t ndryshon edhe nga ai i Schmitt-it edhe nga ai i liberalistëve. Në fakt Mouffe ekspozon një qëndrim “bashkë më Schmitt-in, kundër tij”. Për Mouffe është e pranueshme teza e Schmitt-it mbi dimensionin antagonistik të *politikes*, mirëpo ajo kategorikisht refuzon ndarjen në mik/armik si elementi përbërës i *politikes*. Pra siç vërehet Mouffe pranon tezën se antagonizmat gjithmonë paraqesin një mundësi reale dhe se *politikja* buron nga gjendja jonë ontologjike. Por, mohimi i shumësisë brenda etnitetit demokratik dhe pranimi shumësisë vetëm në nivel të shteteve nga ana e Schmitt-it për Mouffe është e papranueshme. Prandaj si përfundim mund të themi që Mouffe tejkalon edhe qasjen liberale për një politikë pa antagonizma dhe qasjen e Schmitt-it për një politikëbërje mbi ndarjen mik/armik.

Mouffe kundër këtyre dy modeleve si antitezë propozon që duhet njohur dimensionin antagonistik i *politikes*, mirëpo ky dimension duhet zbutur . Pra duhet të imagjinohet një lloj i tretë i marrëdhënieve politike.

Këtë lloj të tretë të marrëdhënies Mouffe e shpjegon nëpërmjet nocionit *agonizëm*. Në këtë kontekst përderisa antagonizma është një marrëdhënie ku “armiqtë” të bazuar në dikotomin Ne/ju nuk ndajnë asnjë terren apo hapësirë të përbashkët, agonizma është një marrëdhënie ky palët në konflikt përsëri të bazuar në ndarjen Ne/Ju njohin legjitimitetin e njëri-tjetrit në mënyrë reciproke (Mouffe, 2013: 28). Pra në marrëdhëniet agonistike palët ndërluftuese nuk janë armiq, por kundërshtarë. Përgjatë kësaj përplasjeje, palët duke e parë veten si pjesë të së njëjtës bashkësi politike, ata në fakt ndajnë një hapësirë të përbashkët simbolike në të cilën realizojnë përplasjet. Duke u nisur nga ky përkufizim Mouffe mendon që roli i demokracisë është që antagonizmat t’i transformojë në agonizma. Pra modeli i kundërshtarit duhet të shihet si një element konstituiv i demokracisë, sepse ky model mundëson transformimin e politikës demokratike antagonistike në politikë demokratike agonistike (Mouffe, 2001: 106).

Më tej Mouffe vazhdon duke thënë që ajo nuk refuzon tërësisht konsensusin, mirëpo sipas saj është ë pashmangshme që konsensusin ta shoqërojnë përplasjet dhe divergjencat. Konsensusi është i nevojshëm për realizimin e vlerave demokratike siç janë liritë dhe barazitë. Por duhet pasur parasysh se gjithmonë do të këtë divergjenca në mënyrën e përjetimit apo realizimit të këtyre vlerave. Në demokracinë pluraliste divergjencat dhe diversitetet janë edhe të nevojshme edhe legjitime, sepse këto përbëjnë bërthamën e *politikës* (Mouffe, 2013: 28).

Sipas Mouffit mosrezistenca e partive socialiste ndaj hegjemonisë neoliberalë paraqet pengesën themelore për realizimin dhe aplikimin të politikës agonistike. Pra siç vërehet këtu e majta është ajo që duhet ta aplikojë këtë lloj të politikës. Mirëpo sipas saj e majta dhe socialdemokratët dështuan në këtë drejtim, sepse pas rënies së bllokut socialist nuk arritën të prodhojnë një diskurs politik autentik dhe si rezultat humbën një mundësi e madhe në kuptimin e gjenerimit të një politike demokratike. Qarqet majtistë në vend që të bashkohen dhe të prodhojnë politika dhe ide të reja, ata pranuan diskursin neoliberal për një fushë politike pa antagonizma dhe pranuan një politikëbërje “pa ata” të tjerët. Në këtë kontekst Mouffe thekson që detyra kryesore e socialdemokratëve nuk është refuzimi komplet i kapitalizmi dhe pranimi i ideve të marksizmit ortodoks, por realizimin e idealeve të social-demokracisë. Natyrisht një gjë të tillë është e pamundur të bëhet pa e sfiduar rendin aktual neoliberal kapitalist (Mouffe, 2013: 41).

Në kapitullin e tretë, Mouffe analizon teoritë e shumë teoricienëve të cilët në vitet 1960 dhe `70-ta hodhën teoritë mbi një periudhë post-politike dhe post-industrialiste. Pra konkretisht Mouffe kritikon teoritë mbi periudhën post-tradicionale të sociologëve Ulrich Beck ve Anthony Giddens-it. Beck në librin e tij *The reinvention of politics* shkruan që ndryshimi shoqëror është realizuar në tre faza themelore dhe atë: faza e parë është faza paramoderne, faza e dytë është faza e modernizimit të thjeshtë dhe faza e tretë është faza e modernizimit refleksiv.

Beck ndryshe nga teoricienët postmodernistë, mohon se gjendemi në një periudhë të ashtuquajtur “periudha postmoderne” dhe se botëkuptimi i sotëm është vetëm një vazhdimësi e modernitetit dhe këtë periudhë ai e emërton si “shoqëria e riskut” apo periudha e “modernizimit refleksiv.” Beck epokën në të cilën jetojmë e emërton si epokë të ambiguitetit, papërcaktueshmërisë, pasigurisë, heterogjenitetit, vlerave të dyfishta dhe e dyshimit (Beck, 2013: 23-24). Sipas Beck-ut dallimi ndërmjet shoqërisë industriale dhe asaj të riskut qëndron në atë se “shoqëria industriale” është e ngarkuar për mbajtjen e përgjegjësisë së rendit shoqëror borgjez dhe kontrollit të prodhimit, kurse në shoqërinë e riskut, mekanizmat e kontrollit janë të pamundura dhe kjo gjendje shpjen në efektet anësore të cilat gjenerojnë paqartësi dhe shumëkuptueshmëri. Si pasojë e kësaj shpesh herë kemi fenomenin e tëhuajësimit të njeriut.

Marrëdhëniet e bazuara në besnikërinë ndërmjet individëve dhe shoqërisë që ishin karakteristikë kryesore e shekullit XX, në periudhën e riskut më nuk janë të vlefshme dhe janë arkaike. Fakti që në këtë periudhë kemi një individ mirë të arsimuar dhe i kualifikuar këto marrëdhënie janë të pakuptimta. Në këtë kontekst në shoqërinë e riskut institucionet e rëndësishme që kanë qenë karakteristikë për shoqërinë moderne kanë humbur rëndësinë e tyre. Pra si rezultat i procesit të individualizimit dhe për shkak të pasojave të globalizimit gjithashtu shteti-komb dhe grupet kolektive kanë pësuar ndryshime radikale në kontekstin konceptimit shkencor. Si pasojë e kësaj Beck mendon që edhe në hapësirën publike edhe në atë private identiteteve kolektive nuk u ka mbetur ndonjë rëndësi, sepse institucionet themelore të shoqërisë nuk janë më familja dhe grupi, por individi. Në shoqërinë e riskut përplasjet ideologjike dhe politike nuk realizohen brenda kornizës së metaforës “e djathtë-e majtë”, sepse kjo korzinë është autentike për shoqërinë industriale (Mouffe, 2013: 49).

Sipas Beck-ut bashkë me shoqërinë e riskut ka gjeneruar edhe një formë e re e politikës dhe këtë formë të politikës ai e emërton si “nën-politikë”. Në këtë periudhë politika duhet kërkuar jashtë parlamentit, partive politike dhe jashtë sindikatave të punëtorëve, sepse sot politika mund të dalë në shesh në shumë vende të ndryshme. Beck pretendon se sot kanë dalë në shesh një sërë formash të rezistencës të cilat nuk janë të lidhura me asnjë parti politike apo klasë dhe si të tilla janë jashtë parlamentit. Pra me daljen në skenë të “nën politikës” individit zë pozitën kryesore të politikës. Sipas Becku-t, “njëra ndër karakteristikat themelore të nën-politikës është formësimi i shoqërisë nga poshtë-lartë. Grupet të cilat më parë përgjatë teknologjizimit dhe industrializimit nuk janë integruar dhe nuk iu është dhënë mundësia e fjalës në proceset politike, me daljen e nën-politikës në shesh grupeve marginale iu është dhënë mundësia për të drejtën e fjalës në formësimin e shoqërisë dhe proceseve politike (Mouffe 2013: 50-51).

Ashtu si Beck-u edhe Anthony Giddens periudhën e sotshme e emërton si periudha post-tradicionale dhe në këtë periudhë sipas tij politikëbërja në formën tradicionale është e pavlefshme. Giddens këto pikëpamje i arsyeton nëpërmjet procesit të globalizimit. Giddens me pavlefshmërinë e politikës tradicionale, ka parasysht që në kohën e globalizimit politikëbërja mbi kallëpet ideologjike të djathtë dhe të majtë është e pamundur dhe se është i nevojshëm një model tjetër i politikëbërjes konform ndryshimeve dhe zhvillimeve shoqërore, të cilat kanë ardhur si pasojë e procesit të globalizimit. (Tavnriverdi, 2009: 864).

Giddens mendon se pas rënies së Murit të Berlinit është krijuar një hegjemoni absolute e kapitalizmit dhe si rezultat i kësaj është humbur edhe dallimi ndërmjet se majtës dhe së djathtës. Pikërisht për këtë shkak shumica e problemeve të kohës së sotme është e pamundur të zgjidhen brenda kallëpeve tradicionale ideologjike. Prandaj ky rend i ri shoqëror, ka nevojë për një politikë të re, pra, “politikë strukturore”. Në këtë kontekst, Giddens propozon konceptin e autonomisë, sepse autonomia është një koncept që nxit marrëdhëniet shoqërore dhe mundëson që përplasjet e interesit të zgjidhen nëpërmjet dialogut publik. Për t’u arritur kjo duhet krijuar hapësira publike në përmasa më të vogla (Mouffe, 2013: 57). Pra nëpërmjet konceptit të autonomisë Giddens kërkon modelin e demokratizimit të shoqërisë, i cili sipas tij realizohet në katër kontekste-fusha të ndryshme:

1. Në fushën e jetës personale, shfaqja e demokracisë emocionale në marrëdhëniet prind-fëmijë dhe marrëdhëniet miqësore,

2. Në fushën organizative, zëvendësimi hierarkisë burokratike me sisteme të autoritetit të decentralizuar,

3. Në fushën e shfaqjes së lëvizjeve shoqërore dhe zhvillimit personal, krijimin e hapësirave dialoguese të cilat do të sfidojnë format e ndryshme autoritare, dhe

4. Në nivelin universal, krijimin e një rendit universal kozmopolit i cili do të mundësonte demokratizimin nëpërmjet dialogut dhe autonomisë.

Si përfundim edhe Beck-u edhe Giddens-i në emër të “demokratizimit të demokracisë” hedhin idenë se është i nevojshëm eliminimi i konceptit “kundërshtar”. Sipas tyre sot problemet themelore politike duhet të zgjidhen në emër të demokracisë dialogjike, dhe këto probleme nuk do të zgjidhen nga grupet por nga individit. Argumentet e tyre themelore mbi këtë janë që në periudhën e riskut janë të pavlefshme identitetet kolektive të konstruara në bazë të ndarjes ne/ata dhe bashkë me këtë janë shkapërderdhur edhe polet politike.

Për Mouffe, pikëpamjet e Becku-t dhe Giddens-i pjesërisht janë të pranueshme, mirëpo ajo mendon që qasja e tyre ndaj politikës në fakt mund të prodhojë politikë pa antagonizma dhe pikërisht në këtë pikë ajo nuk pajtohet me ta. Përveç kësaj Mouffe mendon që qasja e Giddens-it dhe Becku-t nuk është argumentuar mirë dhe se kjo qasje nuk ofron zgjidhje të përshtatshme për shumë sfera dhe fenomene shoqërore. Mouffe duke ju referuar Perry Anderson-it i cili mendon që “*politika nuk është një shkëmbim idesh, por është një luftë për pushtet*” mundohet ti kundërshtoj tezën apo idetë e Beckut dhe Giddens-it. Anderson më tej vazhdon duke thënë se “*rreziku i të konceptuarit të jetës demokratike si dialog, do të thotë të harrosh që demokracia në themel është një përplasje- apo një luftë*” (Mouffe, 2013: 65).

Qasja e Schmitt-it mbi atë se natyra e politikës domosdoshmërisht është antagonistike përbënë mendimin themelor të Mouffe-së. Në të kundërtën nuk mund të flasim për politikë. Mouffe mendon që antagonizmat paraqesin parakushtin kryesor për pluralizmin demokratik dhe si të tilla janë të nevojshme, megjithatë kjo nuk do të thotë që ajo në asnjë mënyrë nuk pranon format demokracisë konsensuale apo dialogjike.

Në kapitullin e katërt Mouffe analizon lëvizjet populiste djathiste e cila si një fenomen anti-demokratik u shfaq në Evropë në vitet

80-ta. Përveç kësaj në këtë kapitull ajo analizon sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe hedh tezen që fundi i sistemit dy polësh dhe kalimi në sistemin multipolar nuk ka sjellë një botë më paqësore, por përkundrazi ky sistem u ka hapur rrugën shumë antagonizmave dhe problemeve të tjera nëpër botë.

Sipas Mouffe shfaqja lëvizjeve populliste djathtiste në Evropë në skenën politike nuk është një fenomen i rastësishëm. Mouffe mendon që shkak kryesor për shfaqjen në skenën politike të lëvizjeve populliste djathtiste në Evropë është pikërisht modeli konsensual i demokracisë i cili në një farë mënyrë u imponua nga mendimi liberal dhe nga idetë majtiste për të ashtuquajturën “rruga e tretë”. Pra tejkalimi i kufijve ndërmjet së djathtës dhe së majtës dhe neglizhimi i debateve mbi politikën agonistike ndërmjet partive politike ka ndikuar që një pjesë e madhe e votuesve apo qytetarëve të mos mund të identifikohen partitë e kampit tradicional. Shpërfillja e identiteteve kolektive dhe shpallja e fitores së individualizmit ka shkaktuar që një pjesë e madhe të identiteteve kolektive interesat e tyre ti realizojnë nëpërmjet alternativave tjera. Kështu këto grupe apo identitete kolektive kanë filluar të identifikohen më popullizmin djathtistë. Si rezultat i kësaj, Mouffë mendon që modeli konsensual i demokracisë ka humbur legjitimitetin në kontekstin e përfaqësimit politik (Mouffe, 2013: 82-85). Identitetet e “përjashtuara” për të cilat flet Mouffe janë shfrytëzuar nga liderët demagogë dhe partitë populliste.

Në këtë kapitull, Mouffe po ashtu trajton çështjen siç thotë ajo “konsumimit të politikës me një gjuhë moraliste” nga ana e partive demokratike dhe liberale. Sipas saj, ky fenomen ka ndikuar dukshëm në ngritjen e lëvizjeve populliste në Evropë. Në këtë kontekst përdorimi i diskursit moralist nga partitë demokratike është bërë shkak kryesor i daljes në shesh të partive populliste. Si pasojë e përdorimit të diskursit moralist është bërë edhe ndarja ndërmjet “demokratëve të mirë” dhe e “djathta populliste e keqe” (Mouffe, 2013: 86).

Për autoren Mouffe ky distinkcion nuk është i pranueshëm sepse ajo vlerëson se konsumimi i politikës me një gjuhë moraliste thëllon akoma më shumë ndarjet dhe krijon antagonizma më të fuqishme në shoqëri. Përveç kësaj ajo mendon se edhe pse partitë demokratike tradicionale përdorin një gjuhë të tillë, ky lloj i politikëbërjes është shumë i pamoralshëm. Mouffe mendon që me vetë faktin e ligjërimit të një diskursi moralist asesi nuk do të thotë që njerëzit në fushën politike gjithmonë sillen në mënyrë objektive dhe thonë të drejtën dhe punojnë



për të mirën e përgjithshme (Mouffe, 2013:88). Për Mouffen, konceptimi i politikës nëpërmjet vlerave morale në fakt eliminon ndarjen Ne/Ata dhe në vend të kësaj lufta politike zhvillohet brenda kornizave të ndarjes ndërmjet të “mirëve” dhe të “këqijve” dhe kjo gjendje ka imponuar nevojme që “të mirët” gjithmonë ti luftojnë të “këqijtë.” Sipas Flahaul-tit, diskursi moralist i zhvilluar nga ana e “demokratëve të mirë” në fakt është një vetë-idealizim.

Sipas Mouffe-së, në momentin kur politika fillon të konsumohet me gjuhë moraliste pamundësohet transformimi i formave antagoniste në agonizma, sepse në këtë rast për “të mirët” nuk është i mundur çfarëdo lloj debati me “të këqijtë”. Bile “të këqijtë” duhet eliminuar. Pra duke u nisur nga këtu, Mouffe vlerëson se pretendimi për tejkalimin e ndarjes mik/armik të Schmittit është një paradoks në vetvete të cilin e ka krijuar vetë diskursi liberal dhe i cili është përvetësuar nga demokratët konsensual (Mouffe, 2013: 88-89).

Më pas, Mouffe trajton çështjen e terrorizmit global dhe në këtë kontekst mundohet të identifikoj shkaqet e terrorizmit. Sipas saj, fillet e fenomenit të terrorizmi nuk mund të jenë spontane dhe shkaqet e tij duhet kërkuar pikërisht në botën një polëshe. Sipas saj, terrorizmi është një fenomen i cili realizohet gjithmonë nëpër kanale jo legjitime dhe se më shpërndarjen e bllokut socialist paradigma neoliberalë dhe kapitaliste ka krijuar një hegjemoni absolute mbi gjithë botën dhe si rezultat i kësaj hegjemonie e cila në esencë është autoritare janë rritur edhe sulmet terroriste (Mouffe, 2013: 91).

Më pas Mouffe shtjellon çështjen e universalizmit të demokracisë liberale. Sipas saj, një nga tendencat e liberalizmit është që vlerat liberale ti paraqes si vlera universale është bërë shkaktari kryesor për shumë probleme nëpër botë. Në këtë kontekst, paradigma liberale duke pretenduar se ngërthen vlera universale politike, ekonomike dhe kulturore nuk lejon daljen në shesh të alternativave të reja. Prandaj shkaqet e disa fenomeneve siç është terrorizmi duhet kërkuar në hegjemoninë e liberalizmit dhe neoliberalizmit. Mouffe mendon që mënyra e vetme për tu përballuar me rrezikun e terrorizmit është krijimi i pluralizmit apo diversiteteve politike dhe kulturore. Në këtë kontekst Perëndimi duhet ndalur që demokracinë ta imponoj si regjimi i vetëm universal për të gjithë botën dhe duhet hequr dorë nga ideja që Perëndimit i takon të “civilizojë” botën e “pacivilizuar”. Prandaj, Mouffe refuzon ose kritikon idenë e Habermasit për universalitetin e demokracisë konsensuale (Mouffe: 2013: 99-101).

Në kapitullin e pestë, Mouffe shtjellon rendin ndërkombëtar dhe në përgjithësi qëron hesapet me ithtarët e demokracisë kozmopolite dhe kozmopolitike. Gjithashtu në këtë kapitull analizon konceptimin e shoqërisë civile dhe të drejtave të njeriut nga perspektiva e demokracisë kozmopolite(tike).

Mouffe në analizat e saja mbi demokracinë kozmopolite mbron idenë e pluralizmit politik dhe kulturor dhe sjell argumente mbi nevojën për një botë shumë polare. Kozmopolistët të cilët mbrojnë idenë e demokracisë universale, theksojnë që duhet bërë reforma në Kombet e Bashkuara dhe propozojnë përforcimin e rolit të institucionit të gjykatës ndërkombëtare. Kurse Mouffe këto propozime apo ide i vlerëson si homogjeniste dhe absolutiste në kuptimin e përqendrimit të të gjitha politikave në një qendër. Sipas saj, ekzistojnë dy versione të kozmopolitizmit: i pari, është versioni i kozmopolitizmit neoliberal i cili mbron tregtinë e lirë, mbron vlerat e liberalizmit dhe në një farë mënyre idealizon politikat globale të Kombeve të Bashkuara. Kozmopolitët neoliberalë mbrojnë një rend botëror i cili do të jetë nën udhëheqjen e SHBA-ve dhe një rend ndërkombëtarë ku do të sundojnë institucionet siç janë Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Organizata Tregtare Botërore. Ky vizion i kozmopolitëve neoliberal sipas Mouffe-it do të bëhet shkak i krijimit të një hegjemonie ekonomike dhe kështu do ta ngushtoj hapësirën politike (Mouffe, 2013: 106).

Kurse versioni i dytë është kozmopolitizmi demokratik i cili i lë më shumë hapësirë politikës. Në fakt ky versioni i jep më shumë rëndësi shoqërisë civile. Protagonistët kryesor të këtij versioni janë Richard Falk dhe Andrew Strauss. Sipas këtij versioni zgjidhja e përplasjeve dhe antagonizmave politike është e mundur nëpërmjet proceseve politike ku qytetari do të jetë në qendër të politikës. Për tu realizuar ky projekt sipas autorëve në fjalë duhet themeluar një institucion gjithëpërfshirës, pra, një Parlament Global, detyra kryesore e të cilit do të jetë demokratizimi i politikës (Mouffe, 2013: 108). Pra, versioni i kozmopolitizmit demokratik në qendër vendos individin dhe shoqërinë civile. Sipas Falk dhe Strauss, nevoja që individi dhe shoqëria të vendosen në qendër të politikës konsiston në atë që sot shumë organizata të themeluara nga individi, grupe vullnetare, shoqëri civile dhe qendra të ndryshme financiare kanë ndikuar në dobësimin e rolit tradicional të shteteve të cilat për një kohë shumë të gjatë janë llogaritur si aktorët e vetëm legjitim në arenën ndërkombëtare. Këto individë dhe grupe në fakt mundësojnë një demokratizim në mënyrë horizontale, pra, prej poshtë-lartë dhe në këtë mënyrë

kontribuojnë në demokratizimin të politikës ndërkombëtare. Pra qëllimi i dy autorëve në fjalë është që edhe shoqërive civile edhe individëve tu jepet e drejta e fjalës në udhëheqjen e politikave botërore (Mouffe, 2013: 111). Për Mouffe, këto propozime apo ide janë të papranueshme, sepse ajo mendon që, ashtu si edhe liberalistët edhe kosmopolitët demokratik shtetin e shohin si pengesë dhe zgjidhjen e kërkojnë në shoqërinë civile.

Më pas Mouffe kritikon librin *Cosmopolitan Democracy: An Agenda for an New World Order* të autorëve Daniele Archibugi-it dhe David Held-it, të cilët në këtë libër shtrojnë tezën mbi “Demokracinë kozmopolitike”. Koncepti i demokracisë kozmopolitike në vete ngërthen temat: si respektimi i të drejtave njerëzore, vetëudhëheqjes, mbrojtjen e ambientit, përdorimin në mënyrë racionale të burimeve natyrore etj. Karakteristika themelore e kësaj qasjeje është tendenca që parimet dhe vlerat demokratike të realizohen dhe apo aplikohen në fushën ndërkombëtare. Archibugi thekson se shteti-komb akoma nuk është zhdukur dhe me idenë e demokracisë kozmopolite ai nuk mbron krijimin e një federate botërore, por qëllimi i demokracisë kozmopolitike është përforcimi i institucioneve demokratike ndërkombëtare ekzistuese. Archibugi njëkohësisht propozon krijimin e institucioneve të reja demokratike nëpërmjet të cilave do të mundësohet pjesëmarrja aktive e më shumë qytetarëve në udhëheqjen e politikave globale (Mouffe, 2013: 112-114).

Sipas autorit Archibugi-t ka ardhur koha që të projektohet një formë të demokracisë e cila do të bazohet në liritë dhe të drejtat e qytetarëve. Sipas tij kjo formë duhet tu japë mundësi që individët në shtetet e tyre të ndikojnë në vendimet politike të cilat kanë të bëjnë me çështjet ndërkombëtare. Vizionin që e ofron demokracia kozmopolitike konsiston në përfaqësimin e kërkesave në nivel global të cilat do të vijnë nga të gjitha grupet etnike, fetare, gjinore, shoqërore etj. Natyrishtë është e logjikshme të parashtrohet pyetja se si do të arrihen të gjithë këto? Sipas vizionit të demokracisë kozmopolitike në fazën e parë do të bëhen një sërë reformash në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe do të formohet një organizatë e dytë të Kombeve të Bashkuara ku do të mbledhen parlamentet rajonale. Përveç kësaj do t’i zgjerohen kompetencat Gjykatës Ndërkombëtare, në mënyrë që, shtetet detyrimisht t’i realizojnë apo aplikojnë të drejtat civile, ekonomike dhe politike. Ndër të tjerash ithtarët e kësaj qasjeje propozojnë edhe

themelimin e një Gjykatë Ndërkombëtare Për të Drejtat e Njeriut (Mouffe, 2013: 114-115)

Për Mouffe këto teza janë të papranueshme. Sepse sipas saj në të njëjtën kohë nuk është i mundur edhe të përforcimi i Kombeve të Bashkuara edhe të kërkosh demokratizimin e kësaj organizate. Mouffe duke ju referuar David Chandler-it, mendon që, përderisa nuk gjenden mekanizma të cilët do të sigurojnë respektimin dhe realizimin e të drejtave të njeriut, ideja për të drejtat kozmopolite është vetëm një projekt i parealizueshëm-utopik (Mouffe, 2013: 116).

Pika e dytë për të cilën Mouffe kritikon modelin e demokracisë kozmopolitike është ajo se kjo ide në fakt vlerat dhe mendësinë perëndimore vendos në qendër. Në këtë kontekst sipas Mouffe kjo qasje sistemin juridik, modelin demokratik perëndimorë dhe të tjera mundohen që ta imponoj si model të vetëm ndaj gjithë botës, kështu duke mos lënë hapësirë për alternativa të tjera. Ajo në librin e saj jep shembull idenë e Heldi-t për një “Komunitet Kozmopolit”, i cili pohon që ky “Komunitet kozmopolit” do të përbehet nga të gjitha shtetet demokratike. Mirëpo Mouffe parashtron pyetjen, se sipas cilave kriteret do të bëhet vlerësimi i nivelit të demokracisë në një shtetë përkatës? Në këtë drejtim Held nuk ofron asnjë asnjë përgjigje apo argument (Mouffe, 2013: 118). Më tej Mouffe pohon që imponimi i modelit të demokracisë liberale si alternativë e vetme mundë të gjeneron rezistenca dhe antagonizma tjera.

Në kapitullin e gjashtë i cili është edhe kapitulli i fundit i këtij libri, Mouffe mbron tezën e demokracisë pluraliste dhe jep sqarime në lidhje me këtë tezë të saj. Në këtë kontekst pluralizmi në konceptimin e Mouffe-it nuk është një pluralizmin i cili synon të përbrendësoj çdo identitet dhe i cili synon bashkimin përfundimtarë demokratik universal. Atë që ajo propozon është një formë të pluralizmit i cili do të përbrendësoj kërkesat brenda kornizava të debatit agonistik dhe do t’i përjashtojë identitetet jolegjitim nga debati agonistik (Celik, 2013: 168). Pikërisht ky përjashtim është argumenti themelor i Mouffe-it që modeli agonistik nuk është një model i cili ngërthen të gjithë divergjencat dhe paralelisht me këtë nuk ka edhe tendenca universale.

### **Conclusion**

All the ideas laid in this book by the author Chantal Mouffe in fact widen the conceptual background of her project for radical democracy. Mouffe, presents her first ideas about radical democracy for the first time in her book “Hegemony and Socialist Strategy” which she

has written together with Ernesto Laclau in the 80's (Mouffe-Laclau, 2015: 7-8). Mouffe says that the work "Hegemony and Social Strategy", "has to do either the reformulation of a socialist project and to give an answer for the crisis of the leftist thought, at the same time also the communist and social-democratic versions." (Interview with Chantal Mouffe, 2011) Apart from enriching the conceptual background of her project for radical democracy, Mouffe in the book "On Politics" also sternly criticizes the existing model of consensual democracy based on liberal and neo-liberal values. So, Mouffe tries to resurrect the left or the social democracy, because according to her with the destruction of the socialist bloc the left unable to produce an authentic discourse has accepted the neoliberal hegemony. So, in brief according to her the avant-garde of agonistic politics and political pluralism must be the left or the social democracy.

### **Bibliografia**

Beck, Ulrich, **Siyasallığın İcadı**, İstanbul, İletişim Yayınları, 2013.

Intervistë me Chantal Mouffe, "Antagonizëm dhe hegjemoni. Demokracia radikale përballë konsensusit neoliberal", 3 Tetor 2011, (<http://www.peshkupauje.com/2011/10>)

Mouffe, Chantal, **Demokrasi Paradoksu**, Ankara, Epos Yayınları, 2001.

Mouffe, Chantal, **Siyasal Üzerine**, (Çev: Mehmet Ratip), İstanbul, İletişim Yayınları, İstanbul, 2013.

Mouffe, Chantal, **Dünyayı Politik Düşünmek, Angonistik Siyaset**, (Çev: Murat Bozluolcay), İstanbul, İletişim Yayınları, 2015.

Laclau dhe Mouffe, **Hegemonya ve Sosyalist Strateji Radikal Demokratik Bir Politikaya Doğru**, İletişim Yayınları, İstanbul, 2015.

Schmitt, Carl, **Siyasal Kavramı**, (Çev: Ece Göztep), İstanbul, Metis Yayınları, 2014.

Tanrıverdi, G. Ezgi "Giddens ve Küresel Demokrasi", **Uluslararası İnsan Bilim Dergisi**", Cilt: 6, Sayı: 1, 2009: 853-878.